



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 8.6.2016, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popoviç, Emilija Rexhepi, Shaip Muja, Salih Salihu.

Mungoi: Haxhi Shala.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë, sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 17.5.2016;
3. Shqyrtimi i temave aktuale;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 17.5.2016

Procesverbali i datës 17.5.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i çështjeve aktuale dhe caktimi i një anëtari për Durrës

Kryesuesja hapi këtë pikë, duke rekomanduar që të vendoset në Komision për çështjet si vijon :

- Për seminarin në Durrës, prej datës 24-26 qershor 2016, sipas mbështetjes së fondacionit SOROS, u delegua deputeti Adem Salihaj.
- Për çështjen e faturave të papaguara për ujë, Komisioni do të insistojë për rregullimin e kësaj çështjeje, përmes ndërmjetësimit me zyrtarët e Ministrisë së Punës, nëse nuk arrihet sukses, Komisioni do t'i drejtohet mbledhjes plenare, me rekomandimin adekuat.
- Pas përfundimit të afatit për konkurrim për zëvendës drejtor në ARRU, Komisioni do të shqyrtojë edhe një herë dokumentacionin dhe mundësisht të caktojë ditën e hënë për intervistimin e kandidatëve, mirëpo kryetarja do të takohet me stafin e personelit dhe të Komisionit, për të caktuar intervistimin, pas konstatimit të rregullsisë së dokumentacionit.
- Rreth kompetencës së Komisionit për Demarkacionin e Kosovës me Malin e Zi, u konstatua që ky komision duhet të kërkojë nga Kryesia e Kuvendit, që të përcillet kjo çështje në këtë Komision, për shkak se është Komision funksional, mirëpo për të hartuar këtë kërkesë të Komisionit, kryetarja autorizoi anëtarin e Komisionit, z. Shaip Muja, që të zhvillojë aktivitetet e duhura me stafin, pastaj të hartohet kërkesa në fjalë. Përndryshe, gjatë diskutimit u tha se Rezoluta e Kuvendit, nga 25 qershori 2015 (**Shaip Muja**), duhet të jetë obliguese për Kuvendin, ngase përcakton se kush duhet të merret me këtë çështje, kurse teatri i kurdisur ka qenë për të larguar popullin nga kjo çështje. Më tutje, ai tha: "Për gabime do të sulmohet ky Komision, e jo ministri i Jashtëm, që ka nënshkruar apo Murat Meha". **Salih Salihu**, gjithashtu insistoi që ky Komision mos të neglizhohet dhe shtoi se kufiri i caktuar me dokumentacion kadastral, është absurd i llojit të vet dhe duhet të insistohet që ajo të caktohet me harta të Beogradit, e ashtu quajtur GEOKARTA. Më tej, ai tha: "Merreni me mend sa probleme do të kemi me kufirin e Serbisë, kur dihet fakti se ajo e ka marrë dokumentacionin kadastral". **Adem Salihaj**, tha se siç duket, me qëllim është shkaktuar mjegull dhe disi fshihet kjo punë, pse ndodhin këto gjëra nuk e di, por Rezoluta e cituar më lart e bën këtë Komision, si kompetent funksional, andaj edhe pse është çështje politike, së pari është çështje hapësinore. Po ashtu, sugjeroi që Komisioni të presë këtë

dokument, pastaj të bëhen aktivitetet e nevojshme. **Murat Hoxha** potencoi faktin se është dashur të bisedohet për kriteret që përcaktojnë kufirin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

Përgatitur nga Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Duda Balje